



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**Legjislatura III**  
**Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri**  
**Mbledhja nr. 04**  
**Data 26. 03. 2008**

**P R O C E S V E R B A L**

Mbledhjen e kryesoi:  
Rrustem Mustafa, kryetar i Komisionit

Të pranishëm në mbledhje ishin:  
Shkumbin Demalija, Bojan Stojanović Emrush Xhemajli, Zafir Berisha, Eqrem Kryeziu,  
Agim Veliu, Naim Maloku, Gani Geci dhe Zylfi Merxha

Mungoi: Bujar Bukoshi,

Nga zyra mbështetëse morën pjesë: Ibush Mujaj,  
Antigona Ibraj, Nur Çeku, Biljana Petrovič

Vëzhgues të tjerë ishin: Armend Beka OSBE, Astrit Istrefi Saferworld, përfaqësues nga OJQ FIQ, Nexhat Shatri Zyra Ligjore e Presidencës dhe përfaqësues nga KIPERED.

Mbledhja filloi në orën 11:00 në sallën N-10, në ndërtesën e Kuvendit të Kosovës.

Mbledhja filloj me këtë rend dite:

**R e n d i i d i t ë s :**

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 12.03.2008
3. Shqyrtimi i raportit të punë së Agjencisë Kundër Korrupsionit
4. Shqyrtimi i kërkesës së Kryesisë së Kuvendit për emërimin e tre anëtarëve në Këshillin e Agjencisë Kundër Korrupsionit
5. Vizita e komisionit në komunitetin lokal të propozuar nga OJQ-të FIQ dhe Saferworld
6. Të ndryshme

**Pika e parë:** Rendi i ditës u miratua pa vërejtje

**Pika e dytë:** Procesverbali i mbledhjes së datës 12.03.2008, u miratua pa vërejtje

**Pika e tretë:** Në lidhje me këtë pikë, kryetari i komisionit Rustem Mustafa tha: Ju keni marrë raportin vjetor për punën e Agjencionit Antikorrupsion të Kosovës të dërguar nga Kuvendi i Kosovës. Në këtë raport pasqyrohen në mënyrë të detajuar punët dhe aktivitetet e kësaj agjencie. Me vendimin e Kryesisë së Kuvendit **Nr. 03/0289/RA-005 Datë 20 mars 2008** kërkohet nga Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri dhe Komisioni për Buxhet dhe Financa që të shqyrtojnë këtë raport dhe të dalin me rekomandime para Kuvendit për punën e këtij agjencioni. Prandaj unë propozoj ta caktojme një grup punues që bashkë me komisionin për buxhet dhe financa ta hartojmë një raport të përbashkët, propozoj që Shkumbin Demalija ti paraprij këtij nënkomisioni, hap debat në lidhje me këtë temë.

**Shkumbin Demalija** tha, unë jam edhe anëtar në një komision tjetër dhe për shkak të angazhimeve të mia nuk kisha deshtë të marr edhe më shumë angazhime. Ai gjithashtu theksoi se gjatë vizitës që ne e kemi bërë në këtë agjencion kemi diskutuar edhe çështjet që janë përfshi në këtë raport, prandaj duhet të angazhohemi rreth këtyre rekomandimeve sepse në rend dite kemi edhe një pikë tjetër që ka të bëjë me emërimin e tre anëtarëve në Këshillin e Agjencisë Kundër Korrupsionit.

**Naim Maloku** theksoi, këtë raport e kemi shqyrtuar edhe ne në Kryesinë e Kuvendit. Është vlerësuar si raport i mirë. Pra ne si komision e kemi obligim ta shqyrtojmë këtë raport bashkë me komisionin për buxhet dhe financa dhe rekomandimet tona të ja paraqesim Kryesisë së Kuvendit. Prandaj unë propozoi Shkumbin Demaliajn, Emrush Xhemajlin dhe Eqrem Kryeziun.

**Eqrem Kryeziu**, tha se unë kam angazhime dhe meqenëse udhëtoj nuk besoi se do ti dal mban kësaj pune mirëpo pasi që ju thoni që është në pyetje vetëm një orë atëherë pajtohem.

Anëtarët e komisionit u pajtuan me zgjedhjen e kësaj përbërje dhe në këtë pikë u përfshi edhe pika e katërt e rendit të ditës.

**Pika e pestë:** Në lidhje me këtë pikë kryetari i komisionit theksoi: Ju e dini se një prej objektivave të Komisionit tonë është bashkëpunimi me OJQ-të, ne kemi një kërkesë nga dy organizata **Saferword dhe Forumi për Iniciativë Qytetare** për të bërë një vizitë në disa lokacione për tu takuar me komunitetin lokal. Prandaj ftoj përfaqësuesin e OJQ-së Saferworld të paraqes se si i kanë parapa ata këto vizita.

**Astrit Istrefi**, gjatë prezantimit të tij tha, së pari e falënderoj komisionin që e ka vlerësuar punën tonë. Forumi për Iniciativa Qytetare dhe Saferworld kanë propozuar që Komisioni Parlamentar për Punë të Brendshme dhe Siguri, nga mesi i muajit prill të vizitoj këshillat e fshatrave dhe këshillat e shkollave të mesme me të cilat ne kemi punuar për të krijuar një siguri më të mirë në komunitet, me qëllim që komisioni të njihet më për së afërmi me rëndësinë e angazhimit qytetar në përmirësimin e sigurisë së tyre. FIQ dhe Saferworld janë të gatshëm që të ofrojnë ndihmën e tyre në caktimin dhe realizimin e këtyre vizitave. Gjithashtu shfrytëzoj rastin që komisionit ti bëj edhe një propozim:

Forumit për Iniciativa Qytetare është duke punuar në partneritet me organizata joqeveritare (OJQ) nga komuna të ndryshme të Kosovës për të ndërtuar një rrjet të OJQ-ve që do të angazhoheshin në mbikëqyrjen civile të sektorit të sigurisë, dhe shfrytëzojmë këtë që ti propozojmë komisionit të caktoj takime të rregullta, mundësisht çdo dy muaj,

për tu takuar me këto organizata në mënyrë që të vendoset një komunikim dhe të bëhet një koordinim për angazhim të përbashkët që do të kontribuonte një mbikëqyrje efikase parlamentare/civile të sektorit të sigurisë në Kosovë. Ju faleminderit.

**Gani Geci**, tha unë kisha deshtë me kërkuar nga kjo organizatë të na e sjellin një organogram.

**Rrustem Mustafa**, stafi është duke punuar në këtë drejtim dhe ne do të caktojmë se kush do të shkoj dhe ku.

**Zylfi Merxha** tha, ky në prezantimin e tij përmendi vetëm vendet ku ka deshtë vetë e jo vendet ku ka multietnicitet, desha me ditë pse nuk ka organizua vizitë në vendet ku ka multietnicitet si p.sh në Prizren.

**Naim Maloku** në lidhje me këtë pikë tha, ne jemi përcaktuar që mbledhjet e komisionit të jenë të hapura për OJQ-të që merren me sektorin e sigurisë, prandaj mendoj se kjo ju ndihmon edhe atyre edhe neve. Pra ju na i sillni neve dy faqe të shkruara ku dhe si do të veprojmë dhe pastaj ne do të marrim vendim.

**Rrustem Mustafa** tha, ne vendimin e kemi marrë, juve ju mbetet vetëm të kontaktoni me stafin për mënyrat dhe rregullat se si do te veprojmë.

Ky propozim u miratua në parim nga anëtarët e komisionit.

**Pika e gjashtë:** Në kuadër të kësaj pike unë si kryetar i komisionit kam parapa katër çështje. E para, siç e dini ne kemi bërë disa vizita ne institucionet e sigurisë pra jemi gati për të përfunduar këtë cikël dhe më pas komisioni do të hartojë një raport për gjendjen në këto institucione që do të shqyrtohet në komision. Përveç kësaj ne do të kemi vizita edhe me institucionet ndërkombëtare të sigurisë si UNMIK-un dhe KFOR-in. Çështja e dytë ka të bëjë me Projektligjin për Sigurinë Private në Kosovë të cilin ju tashmë veç e keni marrë, dhe për këtë projektligj komisioni ynë do të jetë komision funksional. Në leximin e parë në kuvend komisioni do të dal me një qëndrim për këtë projektligj, nëse ky projektligj i plotëson kriteret për procedim të mëtejshëm. Në pikën e tretë unë kam përfshi organizimin e një dëgjimi para komisionit me akterët kryesor të sigurisë në Kosovë, për të diskutuar shqetësimet e përbashkëta.

**Emrush Xhemajli** tha, ne kemi vendos që të bëhet kjo ftes por ka mbet të vendosim kënd ta ftojme, andaj unë propozoj që ti ftojme, Ministrin e MPB-së, përfaqësues nga KFOR-i, përfaqësues nga UNMIK-u, Komandantin e SHPK-së, Kryetarin e Kosovës, Kryeministrin, Komandantin e TMK-së Kryetarin e KK të Mitrovicës etj.

**Gani Geci**, tha pajtohem me Emrush Xhemajlin, unë kisha deshtë me kërkuar nga Ministri i MPB-së të na sjellin një raport në lidhje me ngjarjet pas 17 shkurtit d.m.th pas shpalljes së Pavarësisë.

**Naim Maloku** tha e përkrahi këtë iniciativë, por së pari duhet ta përcaktojmë a është dëgjim apo njoftim dhe a do të mbahet me dyer të mbyllura apo të hapura. E treta duhet ta dërgojmë një agjendë të pyetjeve, unë propozoi tema të jetë siguria në Kosovë si dhe disa nën pyetje.

**Bojan Stojanović** lidhur me këtë pikë tha, unë mendoj se gjendja e sigurisë në Kosovë është e mirë mirëpo me kalimin e kohës kjo do të përmirësohet edhe më shumë, kërkoj nga komuniteti shqiptar që mos të provokoj komunitetin serb duke e llogaritur nervozizmin mental të tyre. Në Mitrovicë ka pasur trazira por mendoj se kjo situatë është tejkualuar shumë shpejt duke ju falënderuar forcës ndërkombëtare, unë e kuptoj

gjendjen e atyre njerëzve atje sepse shumë prej tyre kanë humb pasurin e tyre dhe kërkojnë një siguri më të lartë. Unë me partin time dhe me partitë tjera jemi duke i kontribuuar situatës që të zgjidhet sa më parë dhe të mbretëroj siguria për të gjithë qytetarët që jetojnë në Kosovë.

**Rrustem Mustafa** tha se ky nuk do të jetë as dëgjim publik as njoftim por vetëm një dëgjim para komisionit prandaj propozoj që Emrush Xhemajli të merret rreth çështjes se kënd duhet ftuar dhe çka duhet për të bërë, ndërsa ne lidhje me çështjen e katërt kërkoj një njoftim nga Naim Maloku lidhur me atë se deri ku ka shkuar puna rreth shqyrtimit të Projektligjit për Përdorimin Civil të Eksploziveve.

**Naim Maloku**, ne sot e kemi takimin e dytë të grupit punues për këtë projektligj dhe besoi se javën e ardhshme do ta bëjmë harmonizimin e këtij projektligji dhe do ti sjellim amendamentet për komision.

Mbledhja përfundoj në orën 12:10.

Kryetari i Komisionit  
Rrustem Mustafa